

## STATUTI

### I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "GASHI URBAN " sh.p.k.

Ne baze te ligjit nr.8417, date 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikes se Shqiperise", (i ndryshuar); ligjit 9901 date 14.04. 2008 "Per Tregtaret dhe shogerite Tregtare", Kodit Civil ne fuqi, ligjit "Per QKB-ne", Kodit Doganor, Fiskal e Tatimor, me vullnet te lire e te plote, une Shpend Gashi, i biri i Hysen-it, me datelindje 04.07.1984, lindur dhe banues ne Durres mbajtes I leternjoftimit elektronik me nr. I40704176B, vendosa te krijoj shoqerine me perjegjesi te kufizuar, emertuar si me poshte:

#### KREU I

##### Neni 1

Emertimi, Forma Juridike, Selia, Kohezgjatja, Objekti.

##### Neni 2

Emertimi i shoqerise eshte "**GASHI URBAN**" sh.p.k.

##### Neni 3

Ky statut hyn ne fuqi pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.

#### Neni 4

#### FORMA JURIDIKE

Shoqeria, eshte perjegjese ndaj te treteve per detyrimet dhe demet e shkaktuara gjate veprimtarise se saj.

Shoqeria, eshte nje e tille dhe themelohet nga ortaku qe perballon humbje vetem deri ne kufirin e vleres se kontributit te tij ne kapitalin themeltar.

#### Neni 5

#### Selia

Shoqeria e ka seline ne Durres, Vrrine, zona kadastrale 3339, nr pasurie 46/47.

Shoqeria mund te ndryshoj seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijoj filiale, si brenda ashtu

edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetem me vendim te ortakut.

Neni 6  
**OBJEKTI I VEPRIMTARISE TE SHOQERISE**

Transport udhetares brenda vendit.

Neni 7

**ADMINISTRIMI**

Administrator i shoqerise do te jetë **z. Shpend Gashi**.

Administratori do te ushtroje funksionin ne kete detyre per nje periudhe 5 vjecare duke filluar nga data 27/05/2020- 27/05/2025.

Administratori emerohet dhe shkarkohet nga vendimi i ortakut te vetem.

**KREU II**

Neni 8

**KOHEZGJATJA**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore pa afat te caktuar.

Neni 9

**KAPITALI**

Kapitali themeltar I shoqerise do jetë I perbere nga kontributi I ortakut te vetem themelues te kesaj shoqerije ne para ne vleren 10000,00(dhjetemije) lek dhe eshte 1,00(nje) kuote.  
Themeluesi merr ne pronesi kuoten e tij ne kapitalin themeltar ne perputhje me kontributin e tij .  
Kontributi I ortakut themelues ne kapitalin themeltar eshte si me poshte:  
**Z. Shpend Gashi** 1,00(nje) kuote,me vlore 10000,00(dhjetemije) lek,zoteron 100,00%(njeqind)

Neni 10

**Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit**

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet me vendim te ortakut te vetem, nepermjet nenshkrimave te pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit te nje eksperti kontabel te autorizuar per keto kontribute sipas kerkeses se administratorit. Zvogelimi i kapitalit lejohet, me vendim te ortakut, i cili merret ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.

Projekti i zvogelimit te kapitalit i komunikohet eksperteve kontabel te autorizuar dhe merret vendim rrreth ketij projekti.

Zvogelimi i kapitalit themeltar ne nje vlere me te vogel se ajo e percaktuar ne nenin 9 te ketij statuti, e ben te detyrueshme marrjen e nje vendimi prej shoqerise per zmadhimin e kapitalit themeltar te pakten deri ne vleren minimale.

Ne te kundert shoqeria duhet te shnderrohet ne nje forme tjeter.

Ne rast mosbatimi te kerkesave te ketij paragarfi, cdo person i interesuar mund te kerkoje ne rruge gjyqesore prishjen e shoqerise.

Kjo prishje nuk mund te shpallet, ne qofte se rregullimi eshte bere ne diten kur gjykata mblidhet per te marre vendim.

### Neni 11 **TRANSFERIMI I KAPITALIT**

Pjeset e kapitalit themeltar mund ti transferohen personave te trete qe nuk bejne pjese ne shoqeri, vetem me vendim ortaku.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie. Ato jane te transferueshme edhe ne rast ndarjeje pasurore mes bashkeshorteve. Gjithashtu jane te transferueshme ndermjet bashkeshorteve, si dhe ndermjet paraardhesve dhe pasardhesve.

### **KREU III** ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

#### Neni 12 **Organi Vendimmarres**

Vendimi i Ortakut eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Vendimi i Ortakut te vetem, eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modalitetave te percaktuara ne

Vendimi i ortakut te vetem brenda nje afati prej gjashte muajsh, duke filluar nga data e mbylljes se vitit finanziar, miraton raportin e administrimit, inventarin, bilancin dhe llogarite vjetore, te hartuara nga administratori.

#### Neni 13 **Ndryshimet e Statut**

Ndryshimet e statutit vendosen nga ortaku i vetem. cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB-se per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

#### Neni 14

## Administrimi

Shoqeria administrohet nga nje administrator. Administratori ka te drejte te kryeje te gjitha veprimet e administrimit te zakonshem e te jashtezakonshem. Administratori perfaqeson Shoqerine perpara te gjithe personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo te huaj, autoriteteve shteterore Shqiptare apo te huaja, perfshi ketu autoritetet gjyquesore te gjitha shkallevet.

Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer te Shoqerise , ne te gjitha rrethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji ia jep shprehimisht ortakut. Administratori angazhon shoqerine ne marredheniet me te tretet nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e saj.

Administratori drejton shoqerine ne te gjithe veprimtarine e saj.

Administratori ka te drejte te kryeje veprime dhe transaksione bankare ne emer dhe per llogari te shoqerise “GASHI URBAN”sh.p.k.,prane te gjitha institucioneve bankare te Shqiperise.

Administratori ka te gjitha kompetencat per te punesuar personelin e shoqerise duke respektuar dispozitat e Kodit te Punes.

Shoqeria nuk merr persiper pasojet ndaj te treteve kur ajo provon se te tretet e dinin qe akti I Administratorit e kalonte objektin e shoqerise ose kur te tretet nuk mund to injoronin kete akt ne rrethanat e dhena, duke patur parasysh faktin se vetem shpallja e statutit nuk eshte prove e mjaftueshme.

Klauzolat e ketij statuti qe kufizojne kompetencat e administratorit, te cilat rrjedhin nga ky nen, duhet te respektohen nga te tretet.

Administratorit ose ortaku qe nuk eshte person juridik nuk u lejohet te kontraktojne ne cfareadolloj forme qofte, te marrin hua te shoqeria, te japin pelqimin ne emer te saj, per paradhenie si dhe te behen dorezenes apo te garantojne ne emer te saj angazhimet ndaj te treteve, ne rast te kundert kontrata eshte e pavlefshme.

## Neni 15 PERGJEGJESITE

Administratori eshte perjegjes individualisht, ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise. Pasojet e marreveshjeve te pamiratuara nga ortaku qe i sjellin dem shoqerise, i ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka bere marreveshjen, per to perballuar ne menyre individuale ose solidarisht sipas rastit pasojet perkatese.

Pervec padise per shlyerjen e demit qe i ngarkohet personalisht administratorit, ortaku, ka te drejte te ngreje padi penale kunder administratorit

Paditesi ka te drejte te ndjeki ne rruge ligjore shlyerjen e pote te demit qe i eshte shkaktuar shoqerise, perfshire edhe demshperblimin financiar, nese eshte e nevojshme.

Asnje vendim i ortakut nuk mund te ndaloje ngritjen e kerkese padise kunder administratorit per gabimet e kryera prej tij gjate ushtrimit te detyres.

## Neni 16 VITI FINANCIAR

Viti finanziar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne QKB dhe mbyllt me 31 Dhjetor.

Veprimtaria ekonomike e shoqerise mbylljet me 31 dhjetor te cdo viti. Brenda tre muajve te ardhshem behet mbyllja e bilancit, llogaritja e fitim humbjeve dhe brenda dy javeve nga kjo dite, ortaku i vetem miraton raportin dhe raporton organet shteterore financiare .

**Neni 17**  
**Bilanci i shoqerise dhe dividentet**

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit finanziar, Ortaku i vetem, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Ortaku i vetem me vendim vendos reth shperndarjes se dividenteve, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem finanziar, sic edhe parashikohet nga ligji.

**Neni 18**  
**EKSPERTI KONTABEL I AUTORIZUART**

Aktiviteti dhe rezultati i ekspertit kontabel te autorizuar, konkretizohen ne nxjerrjen e bilanceve periodike dhe vjetore, te cilat miratohen nga ortaku.

Eksperti kontabel te autorizuar mban te gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise, ate gjithvejetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakut.

Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar, pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit finanziar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakut per t'i shqyrtuar e miratuar.

**Neni 19**

Bilanci Kontabel vjetor, miratohet mbi bazen e vendimit me shkrim te ortakut, i cili jo vetem qe dokumenton miratimin e tyre por vendos ne lidhje me disponibiliteten e fondeve ligjore sipas nevojave te zhvillimit te metejshem te shoqerise dhe garantimin e veprimtarise se rregullt te saj, duke pasur parasysh fondin e akumulimit, krijimin e fondit te vecante, krijimin e rezerves ligjore. Rezerva e ligjore krijohet vit pas viti nepermjet lenies menjane te nje shume te barabarte me 5% te fitimit neto te realizuar gjate secilit vit finanziar, deri sa te arrihet nje shume e barabarte me 10% te kapitalit themeltar te Shoqerise.

**Neni 20**

Te ardhurat neto (Dividenti) qe mbeten pas vecimit te fondeve ligjore te mesiperme dhe te atyre per shlyerjen e cdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj te treteve, i mbesin dhe i kalon ne pronesi, ortakut te shoqerise.

**Neni 21**  
**PRISHJA DHE LIKUIDIMI**

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe dhe per cfaredo shkaku, edhe para plotesimit te afatit per te cilien eshte krijuar sic mund te jene:

'Humbja e kapitalit ose pamundesia e vazhdimit te metejshem te veprimtarise se saj. Ne nje nga menyrat e parashikuara nga ligji "Per Falimentimin e Shoqerive Tregtare".

Kur plotesohet afati i caktuar per ushtrimin e veprimtarise tregtare.

Ne kete rast Ortaku merr vendim me shkrim ne te cilin parashikon menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese "Shoperi ne likuidim e siper".

### Neni 22 **BASHKIMI DHE NDARJA**

Shoqeria, me ane te bashkimit, mund t'i kaloje trashegimine e saj nje shoqerie ekzistuese ose nje shoqerie te re qe ajo themelon.

Shoqeria gjithashtu me ane te ndarjes mund t'i kaloje trashegimine e saj disa shoqerive te tjera ekzistuese ose disa shoqerive te reja.

Ortaku i shoqerise, qe ben kalimin e trashegimise se saj ne kuadrin e operacioneve te permendura me lart perfiton pjesa te kapitalit themeltar nga shoqeria ose shoquerite perfituese dhe sipas rastit nje kompensim me para, vlera e te cilit nuk mund te kaloje 10 per qind te vleres Nominale te pjeseve te kapitalit themeltar te dhena.

Operacionet e permendura me lart mund te realizohen ndermjet shoqerive te formave te ndryshme. Bashkimi ose ndarja sjell prishjen pa likuidim te shoqerise qe zhduket, dhe kalimin e pote te trashegimise se saj te shoquerite perfituese, ne gjendjen ne te cilin ndodhet kjo trashegimi ne daten e realizimit perfundimtar te operacionit. Bashkimi ose ndarja sjell njekohesisht per ortakun e shoqerise qe zhduket, marrjen e cilesise se ortakut te shoqerive perfituese sipas kushteve te percaktuara ne kontraten e bashkimit ose ndarjes.

### Neni 23

Afati i emerimit te likuidatorit, publikohet sipas kushteve qe parashikon ligji perkates duke specifikuar dhe dokumentat qe duhen depozituar ne QKB.

### Neni 24

Likuidatori eshte i detyruar qe te jete i vemendshem dhe korrekt, si per realizimin e te drejtave per subjektet ndaj te cileve shoqeria eshte kreditore dhe per ekzekutimin e detyrimeve debive qe shoqeria ka ndaj shtetit, shtetasve te vecante apo personave fizik apo juridik vendas apo te huaj.

### Neni 25

Cdo mosmarreveshje apo konflikt qe mund te lind gjate ushtrimit te veprimtarise se Shoqerise ndermjet ortakut dhe te treteve, si rregull dhe per gjithesisht, ortaku duhet to zgjidhi me mirekuptim, duke iu nenshuar procedurave te detyrueshme te ndermjetesimit, dhe vetem ne te kunderten ceshtja mund te behet objekt konflikti gjyqesor ne Gjykates e Rrethit Gjyqesor Durres.

Neni 26  
BAZA LIGJORE

"Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar

Persa.nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe cfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise dhe praktika nderkombetare.

Neni 27  
Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per cdo mosmarreveshje qe mund te lindin midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Rrethit Gjyqesor Durres.

Neni 28

Shoqeria do kete vulen dhe logon e saj.

Ky statut hartohet me vullnetin e lire te ortakut te vetem dhe nenshkruhet sipas ligjit.

*Durres, me 27.05.2020*

**ORTAKU I VETEM**

**I Shoqerise "GASHI URBAN" sh.p.k.**

Shpend Gashi

*Shpend Gashi  
SIX*